Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Ilir Halili	**26.01.2024**	**06.02.2024**	**2024/0046**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 14.01.2024, OE "LEDI SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2024/0046, kundër njoftimit për kontratë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "LEDI SH.P.K."- Prishtinë, apo kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Marrje me qera te kamioneve per grumbullimin e mbeturinave- Ritender- LOTO" me nr. të prokurimit: "Vete Financim-23-12173-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A..Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedur? t? hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontrat?s: pun?, furnizim, sh?rbim, vlera e parashikuar e kontrat?s: xx,xxx €.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2024/0046 i dt:14.01.2024.Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK-KRM PASTRIMI SH.A – Prishtine ne aktivitetin e prokurimit me titull: "Marrje me qera të kamioneve për grumbullimin e mbeturinave- Ritender – LOTO (LOT 2, 5 dhe 6)" ka rekomanduar per kontrate nje OE. me cmim me te shtrenjte duke na kaluar neve si OE me cmim me te lire, qe i plotesojme te gjitha kriteret e DT-se dhe NJK-se dhe duke e rekomanduar me kontrate nje OE me çmim më të shtrenjtë.

Pra, ne si OE LEDI SHPK, jemi OE i pergjegjshem duke i plotesuar te gjitha kriteret e DT-se dhe NJK-se, AK-KRM PASTRIMI e ka rekomanduar per kontrate OE HEXAGON GROUP per LOT 2,5 dhe 6, i cili ka ofertuar me cmim per LOT-23,400.00 € per LOT 2, 5 dhe 6, kurse ne si OE kemi ofertuar me cmim 21,500.00 € apo 1,900.00 € më lirë per LOT se OE i rekomanduar.

Pra, me kete veprim AK ka demtuar buxhetin e AK-se per 3 LOT-et,. me vlere prej 5,700.00 €.

Me keto veprime, duke na eliminuar neve si OE i pergjegjshem, Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësim të ofertave në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-se, konkretisht neni 1, nenin 6, nenin 7, nenin 59, nenin 60, nenin 69 dhe nenin 72 të LPP-së, poashtu ne kundershtim me vendimin e Kerkeses per rishqyrtim te dates 20.11.2023, e qe sipas kerkeses per rishqyrtim qe ka bere nje OE ne fazen e tenderimit, pergjigje e AK-se (Vendim i AK-se per rishqyrtim), lidhur me pretendimin ankimor i cili ka qene qe te hiqen nga kriteri librezat e pajisjeve, kurse AK ne kerkesen per rishqyrtim per librezat e pajisjeve ka thene (citim):

Pra, shume qarte ne kete vendim lidhur me librezat RKS thote (citim):

Te Kerkesa e DT-se ASETET DUHET TE KENE LIBREZA TE REGJISTRIMIT TE CILAT DUHET TE JENE RKS VALIDE, pergjigje e AK-se per kete pike thote:

NE PRANIM TE MALLIT (PAS KONTRAKTIMIT).

Pra, Kamionet duhet te jene RKS valide ne pranim te mallit, pas kontraktimit.

Kurse Zyra e prokurimit ka shkel kriterin e vet, dhe ne letren standarde per eliminim

Pra, Arsyetimi i AK-se per eliminimin tone ka qene :

OE nuk i ka sjellur librezat per lotot 2,5,6, dhe AK, konkretisht Zyra e Prokurimit e ka shkelur vendimin e vet te dates 20.11.2023 qe thote se librezat kerkohen pas kontraktimit apo ne pranim te mallit.

Vlen te ceket se ne si OE jemi rekomanduar per kontrate per LOT 1, 3, 4 dhe 7, ku ne si OE kemi pasur kamionet e regjistruar per 3 LOT-et, kurse per nje LOT nuk e kemi pasur te regjistruar, por vetem me DUD Doganor, vet AK e ka pranuar, dhe

eshte per qudi me veprimet qe ka bere AK, konkretisht ZYRA E PROKURIMIT, per nje LOT e pranon me DUD-Doganor me libreze te Zvicres – kamioni IVECO, duke i respektuar kriteret e Dosjes dhe Vendimin e kerkeses per rishqyrtim, kurse per LOT-et tjera, arsyetohet pa asnje baze ligjore, por ne menyre injorante se nuk keni prezantuar librezat e kamioneve per 3 LOT-et.

Shkeljet e tilla duhet te sanksionohen sipas ligjit ne fuqi, sepse asnje Autoritet nuk eshte mbi Ligjin.

Kjo eshte shkelje flagrante e LPP-se dhe per keto veprime duhet te mirren masa ndaj Z.P te Prokurimit, per keto veprime antiligjore dhe ne rast se nuk korrigjohet do ti kerkojme edhe KRPP-se, per marrjen e licences sipas nenit 25 te LPP-se

Konkretisht sipas paragrafit 8 te nenit 25 te LPP-se, e qe thote: Çdo certifikatë e prokurimit e lëshuar nga KRPP-ja ose IKAP-i mund të anulohet nga KRPP-ja nëse konstatohet se personi i cili e posedon atë certifikatë nuk i plotëson ose më nuk i plotëson kushtet e kualifikimit të përcaktuara në nenin 23 të këtij ligji ose ka bërë një shkelje të rëndë të këtij ligji ose të rregullave të prokurimit. Nëse poseduesi i certifikatës është nëpunës civil, procesi i anulimit duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat e Ligjit për Shërbimin Civil. Nëse poseduesi i certifikatës nuk është nëpunës civil, KRPP-ja duhet ti dërgojë këtij personi një njoftim paraprak me shkrim prej nëntëdhjetë (90) ditëve për qëllimin e anulimit të certifikatës së tij/saj; ky njoftim i jep personit në fjalë të drejtën e ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative. Nëse pas përfundimit të procedurës së ankesës sipas Ligjit për Procedurën Administrative, personi në fjalë është i pakënaqur me rezultatin, atëherë ai mund të ankohet për anulimin e certifikatës në Gjykatën Themelore – Departamenti për çështje administrative.

Pra, veprimet e tilla te nje zyrtari pergjegjes rezultojne qe te merren masa ndaj tij, sipas paragrafit 8 te nenit 25 te LPP-se.

Veprimet e tilla pos diskriminimit sipas nenit 7 (Barazia ne trajtim/jo diskriminimi), qe eshte e drejte e mbrojtur jo vetem me Ligjin e Prokurimit, por edhe me Kushtetuten e Kosoves, kurse nje AK siq eshte KRM PASTRIMI SHA, pa asnje baze ligjore na

eliminon padrejtesisht duke i shkelur kriteret e DT-se te cilat i ka kerkuar edhe te

ANEKSI 1 - SPECIFIKIMI TEKNIK I DETYRUESHEM

Poashtu, me keto veprime edhe ne vendimin e Kerkeses per rishqyrtim AK ka thene se Librezat duhet te sjellen pas kontraktimit dhe nuk thuhet para kontraktimit .

Njekohesisht AK-KRM PASTRIMI ka demtuar buxhetin publik te qytetareve pa asnje te drejte ligjore.

Andaj, siq e dini edhe ju si OSHP, qellim i LPP-se, eshte kursimi i buxhetit publik, konkretisht kete e sqaron Neni 1 i LPP-së. Pra, qëllimi kryesor i nenit 1 te LPP-se është që të siguroj mënyrën më efikase dhe transparente në shfrytëzimin e fondeve publike, kurse AK në këtë rast ka vepruar në kundërshtim duke rekomanduar një operator për kontratë i cili është me çmim më të shtrenjtë dhe duke demtuar buxhetin publik, qe bie ndesh me ligjin e prokurimit qe ka per qellim, ruajtjen e fondeve publike.

AK nuk e ka marr parasysh Ekonomicitetin dhe efikasitetin, ashtu siq e sqaron edhe nenin 6 i LPP-se, por AK me keto veprime antiligjore ne dem te buxhetit publik, ka shkelur dispozitat ligjore. Poashtu veprimet diskriminuese te nje Autoriteti Kontraktues, qe ka per qellim ta respektoj edhe Nenin 7 të LPP-së bazuar në këtë ne si OE jeni në anën e kursimit të buxhetit krahasuar me OE të rekomanduar per kontrate ka qene dasht te na trajtoj gjithe OE-ve pjesemarres duke respektuar kriteret e DT-se dhe NJK-se. Por jo si ne rastin konkret siq ka vepruar AK duke e demtuar buxhetin dhe duke mos na trajtuar te gjitheve te barabarte.

Pra, me keto veprime, AK ka bere shkeljen e nenit 59 të LPP-së Ekzaminimi, Vleresimi dhe krahasimi i Tenderëve, ku gjate procesit te vleresimit, nuk ka kërkuar sqarime me qëllim të jetë një vlerësim sa ma real dhe te drejte e jo komisioni i vleresimit te mos i respekton kriteret e vet percaktuara nga AK, dhe duke mos e respektuar LPP-ne.

Veprimet e tilla antiligjore qojne ne vazhdimin e procedurave tjera kundrejt AK-se ne organet kompetente dhe kunder Zyrtarit pergjegjes te prokurimit.

AK ka vepruar në kundërshtim me Nenin 60 te LPP-së - Kriteret për dhënien e Kontratës, sipas ketij neni duke rekomanduar për kontratë një OE i cili është me çmim

shumë ma të lart në dem të buxhetit dhe të neve si OE jemi të përgjegjshëm me çmimin ma të lirë sipas DT-se.

Arsyet e eliminimit jane te paqendrueshme te AK-se, dhe ky veprim rezulton qe AK te del ne kundershtim me Nenin 69 te LPP-së.

Gjithashtu AK është dashtë të kërkoj dëshmi apo sqarime shtese në mënyrë që ta bëjë një vlerësim korrekt dhe të saktë te aktivitetit te prokurimit duke i shterrur te gjitha mundesit ligjore qe qojne ne nxjerrjen e OE te pergjegjshem, duke kursyer buxhetit publik, e jo siq keni vepruar ju si AK.

Pra, sipas dispozitave ligjore AK ka bere shkeljen e Nenit 72 te LPP-së Dokumentacioni dhe informacioni shtesë, ku AK KRM PASTRIMI SH.A nuk na ka kërkuar informacione shtesë por AK nuk e ka pare te arsyeshme te sqaron cdo paqartesi sipas nenit 72 te LPP-se, por qellimin e vetem e ka patur eliminimin tone per LOT 2, 5 dhe 6 te ketij aktiviteti.

Ne si OE i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë dhe të DT në përpikëri si dhe jemi OE i përgjegjshëm me çmimin me të lirë dhe si i vetëm në garë për vlerësim dhe nuk jemi në tejkalim të buxhetit të paraparë, pasi që OE i rekomanduar nuk i plotëson kushtet / kriteret e kerkuar ne DT , me kriterin e çmimit më të lirë.

Në rastin konkret kushti për shpërblimin me kontratë ka qenë: Tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, që ka të bëjë me piken 1.1 të këtij Neni dhe AK-ja ka bërë shkelje duke rekomanduar për kontratë një OE që nuk i ka plotësuar kërkesat sipas DT.

Bazuar në pretendimet e cekura më lart kerkojme nga OSHP që te merr:

V E N D I M

APROVOJ si të bazuar ankesen e OE LEDI SHPK, dhe te

ANULOJ Vendimin e AK-se, i cili nuk eshte vendim i drejte konform dispozitave ligjore por eshte diskriminues ndaj neve si OE i pergjegjshem, dhe lenda te kthehet ne

RIVLERESIM, qe ne fazen e rivleresimit pasi qe ne jemi OE i pergjegjshem sipas kritereve te DT dhe NJK-se, te

SHPERBLEHEMI me kontrate, ku ne i plotesojme kriteret e DT-se, dhe ne rast se ka paqartesi AK ne fazen e ri-vleresimit, mund te na kerkon sqarime shtese sipas nenit 72 te LPP-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Tehnička i profesionalne mogućnosti** **1.Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë)** **2. Operatori Ekonomik duhet te posedoje minimum 7 kamion sipas specifikimeve teknike te paraqitura ne Aneksin 1 për realizimin e projektit**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1.Një listë te kontratave të realizuara, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje te furnizimeve si dhe listës ti bashkëngjiten referenca ose certifikata për kryerje te furnizimeve (i) nese sherbimi është bërë për një autoritet kontraktues publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben nje Leter Reference te leshuar nga ana e AK ose fletdergese fletpranim ose dokumentit per pranim teknik te puneve, e cila duhet te jete e nenshkruar nga ana e AK.; (ii) nese sherbimi është bërë për një klient privat, për dëshmi të këtij livrimi ekzekutimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga klienti qe evidenton nje ekzekutim të tillë.** **2. Lista e aseteve me pajisjet përcjellëse, duhet të kenë libreza te regjistrimit te dëshmohen me kopje. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytëzimin, OE duhet te dorezoi edhe marreveshjen per shfrytëzim.**

14

R16 Dosja e Tenderit – Sherbime- Procedur e Hapur

ANEks 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1	VITI I PRODHIMIT	MIN.1997
2	PESHA BARTËSE TË JETË	MIN. 2000 KG- MAX-12500KG
3	KAMIONI TI KETË TË GJITHA PAJISJET DHE ELEMENTET E NEVOJSHME FUNKSIONALE	PA DEFEKTE
4	PAJISJET SINJALIZUESE	FUNKSIONALE
5	ASETET DUHET TË KENË LIBREZA TË REGJISTRIMIT TË CILAT DUHET TË JENË RKS VALIDE	NE PRANIM TE MALLIT (PAS KONTRAKTIMIT)
6	KAMIONËT DO TË VENDOSEN NË PARKINGUN E AK-SË DERI NË PËRFUNDIM TË KONTRATËS;	6 MUAJ
7.	MOTORRI	DIZEL

Me rastin e përzgjedhjes së operatorit ekonomik të rekomanduar, Komisioni Pranues do të del në teren për verifikimin dhe shqimin e aseteve dhe gjendjen e tyre teknike, sipas specifikimeve teknike

Asetet duhet te vendosen ne parking e AK deri ne perfundim te kontrates (24 h).

Kamionet duhet te kene mekanizem funksional per ngritje te kontejnereve 1.1 m3.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

(VENDIMI MBI RISHQYRTIM)

Pergjigje per Operatorin Ekonomik nga Autoriteti Kontraktues:

Autoriteti Kontraktues pas pranimit te kerkeses per rishqytrim ka shqyrtuar ate, dhe i ka hedhur poshte pretendimet e Operatorit Ekonomik, LEDI SH.P.K., ramadan rexhepi, 7, ferizaj, Kosovë.

Autoriteti kontraktues ka shpalle njoftimin per kontrate me date 02.11.2023, ku specifikohet sakt ne faqen 5/7 pika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional: 2. Operatori Ekonomik duhet te posedoje minimum 1 kamion sipas specifikimeve teknike te paraqitura ne Aneksin 1 për realizimin e projektit, Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e aseteve me pajisjet përcjellëse, duhet të kenë libreza te regjistrimit te dëshmohen me kopje. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytëzimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytëzim. (shiko bashkangjitur). I njejti informacion eshte dhene edhe ne Dosjen e Tenderit te shpllaur me daten 02.11.2023 tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale: 9.1 & 9.2, pika 2:
Operatori Ekonomik duhet te posedoje minimum 1 kamion sipas specifikimeve teknike te paraqitura ne Aneksin 1 për realizimin e projektit, Dëshmia e kërkuar dokumentare: 2. Lista e aseteve me pajisjet përcjellëse, duhet të kenë libreza te regjistrimit te dëshmohen me kopje. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytëzimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytëzim.
Pra, Operatori Ekonomik kane qene **dy heresh** i informuar qe gjate vleresimit ofertat e tyre duhet te permbajne listen e aseteve me pajisjet përcjellëse, te cilat duhet të deshmohen me libreza te regjistrimit (kopje).

Sqarimi 1:

Pas pranimit te ofertes, ne procesin e vleresimit, OE sjell vetem nje libreze dhe nuk percakton se cili kamion i perket cilit LOT. AK duke respektuar Nenin 72 te LPP-së, permes letres standarde per sqarim te dates 12.12.2023 kerkon librezat dhe klasfikimin e kamioneve neper Loto.
OE sjell sqarim te manget per pikat e kerkuara dhe nuk pretendon qe kerkimi i librezave rezulton ne shkelje sic po pretendon tani ne kerkesen per rishqytrim.

Sqarimi 2:

OE nuk sjell te gjitha informacionet tek faza e pare e sqarimit (librezat dhe kategorizimin per disa lot), dhe AK **perseri** duke respektuar Nenin 72 te LPP-së, permes letres standarde per sqarim te dates 21.12.2023 kerkon informacionet plotesuese per lot 2,4,5,6,7 (librezat dhe kategorizimin e lotove), perseri OE sjell plotesim per pikat e kerkuara dhe nuk pretendon qe kerkimi i librezave rezulton ne shkelje sic po pretendon tani ne kerkesen per rishqytrim.

Vlene te ceket qe Autoriteti Kontraktues tek Dosja e Tenderit dhe tek Njoftimi per kontrate ka kerkuar listen e pajisjeve me libreza percjellese **per verifikim te automjeteve** (nuk i ka kerkuar librezat valide ne menyre qe mos te demtohen OEte ne rast te jo shperblimit me kontrate), MIRPO, keto libreza te cilat jane prezantuar ne oferten e OEve te shperblyer me kontrate, **DUHET** te jene **RKS valide, PAS KONTRAKTIMIT**, sic eshte percaktuar ne Ankesin 1, Dosja e Tenderit.

Si perfundim OE nuk sjell libreza per LOT 2, LOT,5 dhe LOT 6.

Zyrtari Pergjegjes i Prokurimit bazuar ne ato qe u thane me lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **LEDI SH.P.K.**

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.46/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues

për lotet 2, 5 dhe 6, ku sipas AK-së OE ankues nuk ka sjell librezat per lot 2, 5, 6.

OE ankues pretendon se një gjë e tillë sipas dosjes së tenderit aneksi 1, libreza të regjistrimit të cilat duhet të jenë RKS valide janë kërkuar të ofrohen me rastin e pranimit të mallit (PAS KONTRAKTIMIT), andaj nuk mund të përdoren si arsye për eliminim të Operatorit ekonomik.

OE ankue spo ashtu shton se me rastin e përgjigjes së AK-së në kërkesë pëër rishyqyrtim të një OE, AK ka refuzuar pretendimin për tu hekur pika 5 e aneksit 1, ku sipas AK-së :

"…Pra, shume qarte ne kete vendim lidhur me librezat RKS thote (citim):

Te Kerkesa e DT-se ASETET DUHET TE KENE LIBREZA TE REGJISTRIMIT

TE CILAT DUHET TE JENE RKS VALIDE, pergjigje e AK-se per kete pike thote:

NE PRANIM TE MALLIT (PAS KONTRAKTIMIT).

Pra, Kamionet duhet te jene RKS valide ne pranim te mallit, pas kontraktimit."

Pas analizimit të pretendimeve ankimore, kërkesës për rshqyurtim, përgjigjes se AK-së, si dhe dosjes së tenderit, kemi gjetur se AK në dosje të tenderit FDT pika 9.1&9.2 ka kërkuar :

"*Lista e aseteve me pajisjet përcjellëse, d**uhet të kenë libreza te regjistrimit** te dëshmohen me kopje. Ne rastet kur OE ka mareveshje per shfrytëzimin, OE duhet te dorezoj edhe marreveshjen per shfrytëzim*."

Ndërsa në aneksin 1, pika 5 ka këkruar :

ASETET DUHET TË KENË LIBREZA TË REGJISTRIMIT TË CILAT DUHET TË JENË RKS VALIDE	**NE PRANIM TE MALLIT (PAS KONTRAKTIMSIT**)

Mendimi i ekspertit është se libreza RKS valide decidivisht është kërkuar "në pranim të mallit-**pas kontraktimit**", ndërsa në FDT është kërkuar vetëm "librezë e regjistrimit" (pa RKS).

Nga deshmite ofruara nga OE ankues, i njejti posedon duda doganor dhe libreza te qarkullimit nga shteti prej ku jane blere kamionët, ndersa per libreza RKS valide siq e potencuam me lart ato kerkohen pas kontraktimit.

Meqenëse LPP dhe rregullat e prokurimit në fuqi i obligojnë AK-të që të hartojnë dosje dhe kërkesa të qarta, në të njëjtën kohë nuk e rregullojn problematikën e kërkesave/dispozitave të paqarta, mendimi ekspertit është në rastin konkret mund ti referohemi në nenit 86 nga LIGJI NR. 04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE.

"*Në rastin kur kontrata është lidhur **sipas përmbajtjes së shtypur që më parë**, ose kur kontrata **ka qenë në ndonjë mënyrë e përgatitur dhe e propozuar nga njëra palë** kontraktuese, **dispozitat e paqarta do të interpretohen në dobi të palës tjetër***."

Vlerësimi ekspertit është se në rastin më të mirë, kërkesat e dosjes për libreza janë

konfuze/paqarta, andaj interpretimi i tyre nuk duhet bie në dëm të operatorit ekonomik, përderisa është autoriteti kontraktuesi ai i cili ka hartuar këto kërkesa.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, mendimi ekspertit shqyrtues është se pretendimet ankimore janë të bazuara, dhe se vendimi i AK-së është marr në kundërshtim me pikën 5 të ankesit 1 të dosjes së tenderit.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A.**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **LEDI SH.P.K.**

Ilir Halili

REPUBLIKA E KOSOVËS ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI PRISHTINË/A REPUBLIKA KOSOVA